

VITIKULTURA NE SHQIPËRI

PETRAQ SOTIRI

Historia na meson se vendi yne ben pjese ne truallin e lashte te Ilirise antike dhe se ne jemi pasardhesit autentike te ilirve.

Kur gjeografi i antikitetit , Straboni (63 p.e.r. – 20, e.r.) kalonte neper Iliri, shkruante se «... i ngrohete dhe frutdhenes eshte ky vend, se eshte plot me ullishta dhe me vreshta te mira, perveç ne disa vende te pakta ku toka eshte fare e ashper» (Geographica, libri VII, 8). Ne po kete veper ai shkruante gjithashtu se «Keta te fundit (iliret – P.S.) eksportojne vere, qe e mbajne ne ene druri, te cilat i transportojne me qerre» (libri V. 8., I). Poeti romak P. Vergili Maronis ne Aeneidas shkruante per te paret tane: Ne mes te salles rreth tryezave zbraznin kupat per nder te Bahut, pinin me ene te arta dhe benin flijime (Libri III, 354 – 355). Kurse per token tone shtonte se « .ketu gruri rritet më me bollek, kurse atje vreshtat atje prodhim i mire nga pemet dhe vetem bari gjelberon (Georgicon, Libri pare). Edhe autore te tjere Claudi Aeliani, (shek.II-III e.r.) ; Atheneu, (shek.II p.e.r.) e Theopompi kane shkruar per shkallen e larte te perdorimit te veres, deshmi kjo qe flet per ekzistencen e nje vreshtarie te zhvilluar per kohen e vet.Lidhur me kete deshmi Herodoti (shek. V p.e.r.) shkruan se pellazget (nenkupto iliret –P.S.) arriten t'i njohin emrat e perendive kur i sollen nga Egjypti (por emrin e Dionisit e mesuan pasi mesuan emrat e perendive te tjere). Qe prej kesaj kohe i kane perdorur (perendite) ne flijimet e tyre dhe me pas helenet i morren keto emra nga pellazget». I.G. Kumar, ne enciklopedine e madhe greke (Vol.XVIII) shkruan se pellazget jane shfaqur ne Mesdhe qe nga mijevjeçari i gjashte p.e.r. perpara ardhjes se heleneve; ata njihnin dhe perdornin gjeresisht veren.

Sipas disa etruskologeve (Z. Mayani, 1961) mendohet se fiset etruske jane me prejardhje ilire dhe per keta etruske, Prof. G. Dalmasso (1962,1968) shkruante se ata kane dhene nje kontribut te padyshimte ne perhapjen e artit te pergatitjes se veres ne Italine Qendrore dhe Veriore ne saj te nje niveli te larte dhe te teknikes me te perparuar qe kishin ne problemet e vreshtarise ne krahasim me popujt italike.

Keto pohime nder shume te tjera, mjaftojne per te vertetuar lashtesine dhe madheshtine e vreshtarise antike shqiptare. Qe eshte e lashte vitikultura jone kete e verteton edhe fakti se ne gjuhen sanskrishte rrushi quhet “rasa” qe afron shume fjalen tone “rrush”. Po keshtu ne sanskritishte “vera , quht “nena” ashtu siç e kemi edhe sot ne dialektin e veriut ne gjuhen tone.Me vone latinet e quajten rrushin “racemus” dhe veren “vino”.

Edhe te dhenat nga zbulimet arkeologjike ne vendin tone (nuk mungojne), tregojne gjurme te farerave te rrushit ne formacionet e mijevjeçarit te pare p.e.r.,monedha te prera me figura te vileve te rrushit, mozajka te bukura me vile rrushi (ne Tepe te Elbasanit, Lin te Pogradecit), basorelieve (Apolloni) dhe amfora ne vende te ndryshme te cilat I takojne qyteterimit ilir ne shekujt e fundit te epokes se vjeter dhe ne fillim te eres se re, e pasurojne kuadrin dhe na japin bindjen per te mbeshtetur mendimin mbi lashtesine dhe lartesine e vitikultures ilire. Nga burimet qe disponojme del

se kolonizimet greke dhe romake nuk e sollen ne Iliri perkundrazi, ato gjeten tek te paret tane traditen me te mire te kultivimit dhe te perpunimit te rrushit. Tregu ilir ishte atehere burim eksporti per vererat tona ne brigjet italiane. Amerine M. A. (1967) shkruan se Shqiperia ka nje vreshtari qe i takon periudhes pararomake.

Luftrat e ashpra iliro-romake dhe romako-maqedonase te cilat zgjaten me shume se 250 vjete nderprene vrullin e zhvillimit. Iliria ra nen sundimin romak. Nga shekujt e pare te eres sone Roma arriti te vendose nje fare stabiliteti politik ne territore te pushtuara dhe perseri nga tokat ilire eksportohen prodhime bujqesore, blegtorale dhe ne menyre te veçante vaj dhe vere. Pas ketij lulezimi qe vazhdoi me shume se pese shekuj, burimet historike flasin per shkaterrime te medha te tokes ilire nga dyndjet barbare sidomos ne territorret e banuara nga Taulantet (shek. V-VI e.r.). Keto shkaterrime u pasuan nga renimet e fiseve sllave (shek VI) periudhe kjo qe shenoj renien e vreshtarise sone. Migrimi i fiseve, djegjet dhe luftrat e paprera, sollen shkretimin e kodrave te mbuluara nga vreshtat dhe ullishtet. Megjithate kete ajo nuk u zhduk.

Zhvillimi i vreshtarise sone ne ate kohe, duket edhe nga fakti se vendit tone i kushtohen shume te dhena mbi varietetet e ndryshme te rrushit qe kultivoheshin dhe preferoheshin me teper. Keshtu p.sh. ne mozajken e Linit gjejme disa varietete te ndryshme rrushi per nga madhesia dhe ngjyra e kokrrës. Plini (Plinius Secundus, shek. I. e.r.) jep te dhena per disa lloje rrushi te rritura ne dregdetin ilirik sikurse jane Helovle e Precia, Apiana, Basilika, etj. te cilat, duke gjykuar nga karakteristikat e shkurtera, na shkon mendja tek varietetet tona Vlosh, Kallmet, Pulez, Mjaltez, mereshnik, Kryqes. Plini shkruan gjithashtu se qytetet e Durrahut (Durrësi, P.S.) levdojne Baliskun i cili nga karakteristikat e permendura ka te ngjare te jete Sheshi I bardhe qe sot kultivohet ne zonen kodrinore te Ndroqit dhe Kavajes. Edhe format e shumta qe permenden ne vepren e Kolumeles nuk besojme te jene zhdukur plotesisht ne ditet e sotme, megjithese ne shume raste na kane mbetur vetem toponomi si "Rrashbuelli", "Hardhishte" etj.

Romaket morren shume nga varietetet tona te çmuara. Burimet tregojne se perandoret romake qe perhapen qyteterimin e tyre deri ne qender te Evropes, perhapen atje edhe artin e kultivimit te hardhise edhe menyren e pergatitjes se verës. Ata çuan p.sh. ne Hungari fise ilire te zote per punet e vreshtave dhe te pergatitjes se verës. Keta ilire muarne me vete edhe varietetet tona me te mira duke u bere keshtu shkak per perhapjen e gjere te tyre. Keshtu p.sh. varieteti yne Kallmet (Zadrime, Gjashore) me origjine nga zona e Zadrimes dhe e Shkodres, ne saje te cilesive te tija shume te mira per vinifikim, mori perhapje shume te gjere nen emrin Kadarka, Skadarka, Skutariner, Zhschwartzes, Tokaj nero di Skutari, Nero della Mosella etj. Ne rajonet e Evropes Qendrore (Hungari, Serbi, Kroaci, Tirol).

N. Nedellçev e mohon prejardhjen e varietetit Kadarka nga zona e Shkodres dhe merr persiper ta bullgarizoje ate nen emrin Gëmza, ne nje kohe kur burimet me te mira flasin qarte per kete. Cv. Penev (1930) shkruan se Gëmza eshte perhapur prej romakeve. Ampelografi italian Rovasenda e quan Kallmetin – Tokai Nero di Skutari. Me te njejtin emer e permend edhe D. Cavazzo (1934), i cili thekson se ky varietet eshte me origjine nga Shqiperia. Edhe sorte te tjere me origjine nga vendi yne kane marre perhapje dhe emra te ndryshme ne vende te tjera. G. Molon (1906) permend varietetin Albana Bianca qe e identifikon me Albanella, i cili me sa duket duhet te jete me origjine nga vendi yne. Ne sinonimet e permendura mbi varietetin Albanella, perveç emertimit Greco Bianco, jepet dhe Pulce (D. Cavazza, 1934), i cili sipas pershkrimit ne ampelografine e Molonit, ka shume te ngjare te jete Pulzi yne.

Me emrin Albana dhe Greko ne Itali sot gjejme nje numer te madh varietetesh dhe formash te cilat jane perhapur aty gjate luftrave dhe marredhenjeve tregtare me popujt fqinje. Keshtu p.sh. permendet Refosco i Ilirise (Geothe,1878),Raboso di Piave me sinonimin Gruaja (Molon,1906, Cavazzo.1934) e perhapur ne Itali prej Dalmacie. Keto forma sikurse shumica e formave dalmate, per mendimin tone jane me origjine ilirike.Ne burimet italiane Albanella njihet me emrin Tokaj Bianco di Scutari.

Molon permend se varieteti Zafner merr emertimet Mosler, Posip, Posipon, Tokauer dhe Furmint. Por ne zonat tona veriore si edhe ne territoret jashte kufirit tone (Kosove, mal te Zi, Serbi) Furmintin e gjejme me emrin Bella Skadarka qe vendasit e quajne Kallm,et i Bardhe.

Ne zonat e Korçes, Beratit, Skraparit etj. Gjendet i perhapur varieteti yne Serin i njohur ne dy forma : i bardhe dhe i zi. Ky varietet I perhapur ne France me te njejtin emer sipas mendimit te shume ampelografeve ka vajtur atje nga vendet e jugut. Ka te ngjare qe Serini te jete shpure ne France prej te pareve tane qe emigronin ne ato kohe.

Ne shekujt e VIII-X, kur vendi yne ndodhej nen perandorine bizantine, ndahej ne dy thema : e Duresit dhe e Nikopojes. Per kete periudhe burimet flasin pak mbi fatin e vreshtarise sone, por duke gjykuar nga materialet shume te pasura per hardhite te shkruar ne Gjeoponiket, ne mund te flasim per nje ringjallje te ketij aktiviteti ekonomik edhe ne truallin tone. Kete mendim e perforcon fakti se mjaft nga normat e ligjit agrar (Nomos georgocos) dhe te Statutit te tatimeve si akte legjislative te qeveritareve bizantine, i ndeshim ne te drejten zakonore te koheve te fundit ne fshatrat dhe viset shqiptare. Ne kete kohe cdo fshatar kishte aren e vet (neni 1), kopshtin e vet (neni 3), vreshtin e vet (neni 21, 59,80). Ne legjislacionin bizantin nen te cilin zhvillohej krejt jeta e vendit tone flitet gjeresisht mbi vreshtarine dhe veren. Ketu mjafton te permendim se nga 85 nene , 17 flasin per vreshtat, ,mase kjo qe tregon se ne ate kohe vreshtaria dhe arti i berjes se veres ishin aktivite te dores se pare ne ekonomine e territoreve tona.

Shekujt XI – XII-te e gjejme Shqiperine me nje zhvillim te madh te vreshtarise, por luftrat e reja i sollen asaj edhe njehere shkaterrimin.Kete e deshmojne shkrimet qe bejne fjale mbi zbarkimet e normaneve ne

Shqiperi, te serbeve, kryqezatave, fiseve bullgare etj.te cilet vazhduan deri ne shek.XIV kur ne vendin tone filloi depertimi venetikas. Nje udhetar anonym qe vizitonte viset tona ne vitin 1308 shkruante: toka eshte e pasur me mishra , djathra, qumesht; buke dhe vere nuk kane shume, por kane mjaft sidomos bujaret...Ushtrojne bujqesine dhe rrisin vreshtat dhe I ruajne gjerat e nevojshme ne shtepite e tyre (Q.Gorka,Anonymi Deskriptio EuropaeOrientalis, f. 25-29. Origj.ital.). Ne nje document venetikas qe I takon viteve 1416-1417 thuhet se...Gruemirasit ne vend te dhjetes (se rrushit P.S.),duhet te paguajne çdo vit dhjete bare vere, qofte se vilet ose jo...dhe jane te detyruar ta shpien ne Shkoderme shpenzimet e tyre (F. Cordignano-Catasto Veneto di Scutari f.79-80,origj. Ital.).

Dokumentat venetikase qe I takojne shekujve te XIV dhe XV flasin me hollesi mbi vreshtarine dhe vernat e vendit tone qe prodhoheshin ne zonat bregdetare te Adriatikut dhe tregtoheshin nepermjet skelave te Duresit, Lezhes etj. Dukej sikur zgjerimi I ketyre marredhenieve dhe lulezimi I vreshtarise do te ecte edhe me tej. Edhe sot ruhet kujtimi I “Kodres se veres” ne Kodhel (Shkoder)kur dikur ka qene tregu I grumbullimit dhe eksportimit te veres.

Por, invazioni me I eger, I osmaneve shkaterrroi perfundimisht çdo gje qe gjeti perpara. Hughes V.a. Jan, pas vitit 1788 shkruan per Shqiperine :Kusaria kishte arrire ne nje pike te tille sa qe bujqesia ishte braktisur, tregetia amullonte, çdo shenje qyteterimi zhdukej dhe gjithe vendi nuk paraqiste veçse nje tablo te pergjitheshme mjerimi dhe varferie. Ne fazat e para te pushtimeve turke ruhej ende tradita e lashte e

kultivimit te hardhise dhe e perdorimit ne mase te gjere te veres nga te paret tane .Starine (V.XII. F.193-200, origj. italisht) ne nje relacion mbi Shqiperine ne vitin 1570 shkruante: ...Dhe pastaj prej ketij lumi (Shkumbin P.S.)gjer te nje tjetër qe quhet I Pyrgut, kurse te tjere e quajne Keneta e Karavastase (Dies carvastri) fillon nje bregdet me rere I mbushur me pyje dhe vreshta. Vete burimet turke (H. Inalçik) flasin mbi ekzistencen e nje vreshtarie te zhvilluar ne zonat bregdetare, ne Gjirokaster, Berat, Kavaje, Rrogozhine , Krrabe, Kruje, Tirane, Elbasan, Puke, Durres, etj. Te dhena te rendesishme gjejme ne kanunamene e Terhalles (Berkan, O.L.1520)te Shkodres (1570), te livase se Vlores (1585), te Ohrit (1613)Beratit , Elbasanit, etj. Ku del qarte shkalla e larte e lulezimit te vreshtarise dhe e perdorimit te veres nga te paret tane.

Gjate kesaj periudhe te gjitha statutet dhe kapitulacionet qytetare te qyteteve shqiptare te shek. XV u kushtojne vemendje te madhe problemeve te vreshtave , sepse prej tyre siguroheshin te ardhura te miraper doganat e sundimtareve.Edhe ne qytetet kishte vreshta qe shfrytezoheshin nga vete qytetaret e pasur. E. Çelebi shkruante se Shkodra ka edhe nje shumice punonjes te cilet merren me vreshta dhe kopshte. Shkodra ka 23000 vreshta.

Luftrat dhe ligjet e rrepta otomane qe ndalonin perdorimin e veres si dhe taksat e rend ate vena nga pushtuesit mbi vreshtin dhe veren, shpejtuan rritmet e shkaterrimit ne mase te aktivitetit viti-vinikol. Marin Bici, ne nje relacion mbi demet ne Zadrime shkruan per ate kohe se pushtuesit u prene rrethet fuçive te verres dhe bene perdhunime te shumta. Te kesaj periudhe jane edhe gojedhanat mbi “Rkajen e venes”, kur turqit happen depozitat dhe derdhen si rreke veren tone ne lumenj. Te shumta jane dokumentat qe flasin per nivelin e larte te vreshtarise dhe per fillimin e rrenimit fatal te keti aktiviteti ne vendin tone gjate periudhes se pushtimeve turke(Theiner, Starine, Sforzza etj).Terheqin vemendjen ne menyre te veçante edhe shkrimet e udhetarit turk Evlija Çelebi (shek XVII) ku ne gjejme plot pershkrime mbi tokat tona te mbushura dhe te stolisura me vreshta dhe kopshtije (delvine , Gjirokaster, Berat, Vlore, Kavaje, Peqin, Elbasan, Shkoder, Pogradec etj). por qe u shkretuan me pas. Nga punimet per hapjen e tokave per vreshta te reja, jane zbuluar gjurme vreshtash dhe sistemimesh ne Tirane e Lushnje; ne pyjet e Matit jane gjetur qilare dhe qypa ku ruhej vera. Ne nje relacion te Frang Bardhit mbi Zadrime te shkruar ne 10 prill1641 thuhet :”Shtrihet Zadrime ne Shqiperi si nje krahine me vehte, ndermjet dy qyteteve te Shkodres dhe te Lezhes, ne nje fushe shume te bukur,me te shumten ne breg te Drinit, me arra shume te plleshme dhe te begateshme me çdo fryt e sidomos grure, mel e vene, fiq, dardha, kumbulla, shega, pjepna e shalqinj...”

Emigrimi I popullit tone ne vende te tjera, ndalimi I perdorimit te veres, perhapja e fese muslimane dhe taksat e renda per vreshta dhe tregetimin e veres, bene qe vreshtaria jone te pesoje katastrofen me te madhe; vendin e vreshtave te bukura, pemeve, vilave dhe kantineve e zune lisat dhe ferrat: aty ku mbeten ullishtet e renuara dhe vetem toponomite “vreshta”. Te tilla zona ku u zhduken pothuajse fare vreshtat ishin Shkodra, Lezha, Puka, Mirdita, Mati, Dibra, Kruja, Durresi, Lushnja, Fieri, Berati, Girokastra, Saranda etj. Vreshtaria u perqendrua vetem ne disa “oaze” si ne Leskovik, Permet, Pogradec, Korçe, ne zonen e Ndroqit, ne Narte, dhe shume pak ne Shkoder, Himare, Sarande. Ne zonat e thella filloi kultivimi I hardhive ne forme pjergulle dhe ne erreke sikurse verehet sot ne Mat, Librazhd, Skrapar, Shkoder, Gramsh, Elbasan,Tirane etj. Varietetet tona te çmuara filluan dale nga dale te zhduken, ndersa nga orienti vinin me shumice te tjera per ngrenie si ato te tipit Razaki, Stambollesha, Moskatet; Sulltanina, Çausi, Japinxhak, Kadin parmak,Çelepiyzyn etj. te cilat sot I gjejme te perhapura neper pjerrgulla, ereke, oborre dhe shume pak ne vreshta. Prodhimi dhe konsumi I veres pothuajse u nderpre. Filloi te perdoret rakia (shek. XVII).

